



Kosovo Police 

11h · 



Arrestohet një i dyshuar për përdorim të paligjshëm të armës

Rahovec, 27 Tetor 2024

Me datën 27 Tetor 2024 rreth orës 18 e 30, zyrtarët policorë në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Gjakovë kanë ndërmarrë një veprim të shpejtë dhe efikas për kapjen dhe ndalimin e një personi të dyshuar për posedim të paligjshëm dhe përdorim të armës, ngjarje kjo e ndodhur në fshatin Xerxë-Rahovec. Një patrullë e trafikut rajonal, gjatë patrullimit të saj rutinë, ka vërejtur një të dyshuar mashkull të moshës madhore duke shtënë me armë zjarri. Pas identifikimit të vendndodhjes së të dyshuarit, patrulla policore ka reaguar menjëherë duke arritur të lokalizojë dhe të arrestoj të dyshuarin. Në vendin e ngjarjes, janë gjetur dhe sekuestruar arma e përdorur, katër gëzhoja, si dhe 46 copë fishekë. Me vendim të prokurorit kujdestar, i dyshuari është ndalur në mbajtje për 48 orë si dhe është iniciuar rast “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar në ruajtjen e sigurisë publike dhe në reagimin e shpejtë ndaj çdo situatë që cenon rendin dhe qetësinë.



 41



Like



Comment




Send



Share



Write a comment...



Ari Anna
Lovely 🥰



3h

Like

Reply

